



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. __, DATË __/__/2025

PËR

**MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK
PROCEDURË E VEÇANTË” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “PARKU I
INTEGRUAR EOLIK DHE FOTOVOLTAIK KIRAC”, ME SUBJEKT “KIRAC
GREEN ENERGY” SHPK NUIS M32213041L**

Në zbatim të neneve 8, 9, 17, 18, 22, 24, 26, 27 dhe 30 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Projekti i investimit është në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 8 pika 3, gërma a/ii, të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar.
- Projekti i investimit propozohet të realizohet nga subjekti aplikues “Kirac Green Energy” sh.p.k. NUIS M32213041L. Ky subjekt operon si pjesë e Kirac Group i themeluar që në vitin 1982 me një eksperiencë shumëvjeçare që shtrihet në 41 vende të botës dhe konsiderohet market lider në Turqi dhe në rang global, i specializuar në zhvillimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e projekteve të energjisë dhe infrastrukturës.
- Projekti i investimit i plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikon të punësojë rreth 124 (njëqind e njëzet e katër) persona.
- Vlera e investimit të projektit të investimit “Parku i Integruar Eolik dhe Fotovoltaik Kirac” i plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 129,999,988 Euro (njëqind e njëzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë milion) Euro.
- Projekti i investimit parashikon një sistem hibrid gjenerimi të energjisë dhe përkatësisht ndërtimin e një parku të integruar eolik dhe fotovoltaik i cili do të ketë në total një kapacitet të instaluar prej 125 MW. Ky projekt strategjik, ndër më të

mëdhenjtë në Shqipëri, pritet të kontribuojë ndjeshëm në sigurinë energjetike të vendit.

- Projekti hibrid zë në total një sipërfaqe prej 269.373 ha. Sipërfaqja në të cilën shtrihet projekti prek Bashkinë Lezhë dhe Bashkinë Vau i Dejës, nga të cilat:
 - a. Sipërfaqja e parcelave në pronësi të Bashkisë Lezhë është 99.2 ha;
 - b. Sipërfaqja e parcelave në pronësi të Bashkisë Vau i Dejës është 152.7 ha;
 - c. Sipërfaqja e parcelave në pronësi shtet është 2.5 ha;
 - d. Sipërfaqja e parcelave pa informacion kadastral është 14.9 ha.
- Subjekti aplikues me qëllim studimin dhe kryerjen e matjeve në terren ka nënshkruar dy kontrata qiraje me Bashkinë Lezhë për ushtrimin e veprimtarisë për vendosjen e anemometrave, përkatësisht:
 - i. Kontrata me nr. 2733/2 prot., datë 19.04.2022, me afat 2 vjeçar;
 - ii. Kontrata me nr. 16348/3 prot., datë 01.10.2021, me afat 2 vjeçar.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Miratimin e Statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë” për projektin e investimit “Parku i Integruar Eolik dhe Fotovoltaik Kiraç” në sektorin strategjik të energjisë, me vlerë të parashikuar investimi 129,999,988 (njëqind e njëzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë milion) Euro.
2. Projekti i investimit strategjik “Parku i Integruar Eolik dhe Fotovoltaik Kiraç” do të zhvillohet nga subjekti “Kirac Green Energy ” sh.p.k. NUIS M32213041L.
3. Projekti i investimit strategjik do të zhvillohet në ZK nr. 1624, 2263, 2707, 2778, 3650, 3941, 1920, 2708, 3769, Bashkia Lezhë dhe Bashkia Vau i Dejës, sipas hartës në Aneks 1 të miratuar në parim nga ky vendim.
4. Statusi “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Vecantë” i jepet projektit të investimit “Parku i Integruar Eolik dhe Fotovoltaik Kiraç” për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
5. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, përkatësisht neni 22, neni 24 dhe neni 27 i Ligjit Nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, masat mbështetëse që i jepen projektit të investimit strategjik janë si më poshtë:

- a. Miratohet masa mbështetëse e kryerjes së procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
- b. Miratohet masa mbështetëse e asistencës në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, në përputhje me afatet e parashikuara sipas legjislacionit të investimeve strategjike;
- c. Miratohet në parim masa mbështetëse dhënia e së drejtës së përdorimit dhe vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, për pasuritë sipas gjurmës në Aneks 1 të këtij vendimi. Në zbatim të nenit 9, pika 3/c të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, miratimi përfundimtar, në funksion të realizimit të projektit strategjik, do të parashikohet pas identifikimit të qartë të gjithë listës së pasurive që prek ky projekt investimi dhe shprehjes së dakordësisë të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Lezhë dhe Këshillit Bashkiak të Bashkisë Vau i Dejës për përfshirjen në inventarin e këtyre Bashkive edhe të atyre pasurive që nuk janë ende pjesë e inventarit.

Gjithashtu, për zhvillimin e mëtejshëm të procedurave lidhur me këtë projekt investimi nevojitet dokumentacion lidhur me formën e përdorimit të tokës, bazuar në Ligjin 57/2020 “Për pyjet”, si dhe VKM-në Nr.171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe Fondit Kullosor, përcaktimin e strukturës, kritereve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”, si dhe sipërfaqet që mund/parashikohen të hiqen nga fondi pyjor/kullosor për projektin.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës do të asistojë këtë proces. Në çdo rast, kontrata e qirasë për vënien në dispozicion të investitorit të pasurive të paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, do të vlerësohet për t’u nënshkruar nga Bashkia Lezhë dhe Bashkia Vau i Dejës, sipas përkatësisë dhe legjislacionit të tyre sektorial.

6. Mënyrat, procedurat, afatet dhe organet zbatuese për ofrimin e masave mbështetëse përcaktohen në planin e veprimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
7. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit strategjik “Parku i Integruar Eolik dhe Fotovoltaik Kiraç” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e vecantë, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të anulojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
8. Referuar Ligjit Nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, ngarkohet Bashkia Lezhë dhe Bashkia Vau i Dejës të përfshijnë projektin e investimit strategjik në Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

9. Referuar Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” ngarkohet subjekti aplikues t’i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis të këtij projekti që në këtë fazë paraprake.
10. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës, pas vlerësimit të Qeverisjes Vendore Bashkia Lezhë dhe Bashkia Vau i Dejës, të realizojë procesin e identifikimit të listës së plotë të pasurive shtetërore që prek ky projekt investimi. Në vijim, në rast dakordësie të njësive të qeverisjes vendore Bashkia Lezhë dhe Bashkia Vau Dejës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës do të duhet të iniciojë Vendimin e Këshillit të Ministrave për regjistrimin/transferimin në pronësi të këtyre bashkive të pasurive që preken nga ky projekt investimi, sipas përkatësisë, me qëllim mundësimin e realizimit të këtij projekti.
11. Ngarkohet ministria përgjegjëse për mjedisin, Bashkia Lezhë dhe Bashkia Vau i Dejës për heqjen nga fondi pyjor dhe kullësor të sipërfaqeve që preken nga ky projekt investimi, në rast se evidentohet një nevojë e tillë.
12. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit, të miratuar me këtë vendim.
13. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.
14. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet investitorit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
15. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCEVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)

PLANI I VEPRIMIT

**PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK “PARKU I INTEGRUAR
EOLIK DHE FOTOVOLTAIK KIRAÇ” ME SUBJEKT “KIRAC GREEN
ENERGY” SHPK NUIS M32213041L**

1. *Përmbajtja e planit të veprimit*

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza.

2. *Zbatimi i planit të veprimit*

Plani i veprimit monitorohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t’i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

3. *Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit “Parku i Integruar Eolik dhe Fotovoltaik Kiraç”*

Ky plan veprimi për realizimin e këtij projekti investimi, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të projektit “Parku i Integruar Eolik dhe Fotovoltaik Kiraç” është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

4. Hapat procedurale

Propozimi nga investitori:

Investitori “Kirac Green Energy” sh.p.k., kur paraqiti projektin e investimit tek AIDA, në përputhje me legjislacionin, ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e investimit strategjik.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

Masat e kërkuara	Rekomandimi	Institucioni përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar në faza. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto
Konsolidim toke si dhe identifikim i listës së plotë të pasurive që prek projekti i investimit;	Po	Bashkia Lezhë Bashkia Vau i Dejës ASHK				
Vënie në dispozicion të pasurive shtetërore;	Po, me kusht Sipas vlerësimit të Qeverisjes Vendore	Bashkia Lezhë Bashkia Vau i Dejës ASHK	Miratimi përfundimtar, në funksion të realizimit të projektit strategjik, do të parashikohet pas identifikimit të qartë të gjithë listës së pasurive që prek ky projekt investimi dhe shprehjes së dakordësisë së Këshillit Bashkiak të Bashkisë Lezhë dhe Këshillit Bashkiak të Bashkisë Vau i Dejës për përfshirjen në inventarin e këtyre Bashkive edhe të atyre pasurive që nuk janë ende pjesë e inventarit. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do të asistojë këtë proces. Në vijim, në rast miratimi, Agjencia Shtetërore e Kadastrës do të duhet të iniciojë			

			Vendimin e Këshillit të Ministrave për regjistrimin/transferimin në pronësi të këtyre bashkive të pasurive që preken nga ky projekt investimi, sipas përkatësisë, me qëllim mundësimin e realizimit të këtij projekti. Ministria përgjegjëse për mjedisin, Bashkia Lezhë dhe Bashkia Vau i Dejës do duhet të iniciojnë procedurat për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqeve që preken nga ky projekt investimi, në rast se evidentohet një nevojë e tillë. Në çdo rast, kontrata e qirasë për vënien në dispozicion të investitorit të pasurive të paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, do të vlerësohet për t'u nënshkruar nga Bashkia Lezhë dhe Bashkia Vau i Dejës, sipas përkatësisë dhe legjislacionit të tyre sektorial.			
Marrje e të gjitha lejeve, licencave, autorizimeve të nevojshme sipas legjislacionit në fuqi për operimin.	Po	Institucionet kompetente AIDA	Sipas legjislacionit sektorial Ligj 55/2015 i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim			

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)